

IDC_NOR_02: Rezultatet Përfundimtare të Bashkimit të Tregut

Shënime

Si parim i përgjithshëm, sapo ndodh një ngjarje që pengon kryerjen normale të një procesi, operatorët i referohen **IDC_BUP_02**.

Përmbajtja

1.	Hyrje	3
1.1.	Përmbledhje	3
1.2.	Qeverisur / Rregulluar nga.....	4
1.3.	Mjetet dhe Protokolli i Komunikimit.....	4
1.4.	Procedurat shoqëruese	4
2.	Procedura	4
2.1.	Parakushtet për të filluar	4
2.2.	Pasqyrë e përgjithshme	4
	<i>Tabela 2 – Procesi i Rezultateve Përfundimtare të Bashkimit të Tregut IDC</i>	<i>6</i>
2.3.	Sqarimi i Procesit.....	6
2.3.1.	Dërgimi i Rezultateve të Bashkimit të Tregut për konfirmimin përfundimtar (7a).....	6
2.3.2.	Verifikimi i Rezultateve të Bashkimit të Tregut (8a).....	7
2.3.3.	Marrja e Rezultateve Përfundimtare MC nga Rezultatet e Bashkimit të Tregut (8b)...	7
2.3.4.	Dërgimi si Rezultate Përfundimtare Globale të Rezultateve të Bashkimit të Tregut (8f) 7	
2.4.	Përfundimi	8


1. Hyrje

Kjo procedurë përshkruan procesin e verifikimit të Rezultateve të Bashkimit të Tregut nga OST-të, nga ku rezultatet pasqyrohen në kohën e synuar në Rezultate Përfundimtare të Bashkimit të Tregut MC (██████).

Ky proces kryhet në Sistemin TI të OST-ve.

Verifikimi konsiston në validimin e Rezultateve të Bashkimit të Tregut përkundrejt Kapaciteteve Ndërkufitare dhe Kufizimeve të mundshme të Alokimit.

Sapo të konfirmohen Rezultatet e Bashkimit të Tregut nga Sistemet e Verifikimit, Rezultati Përfundimtar i Bashkimit të Tregut i përcillet prej NEMO tek Sistemi TI i Ofruesit të Shërbimit MC, me qëllim që ky i fundit të prodhojë dhe shpërndajë Rezultatit Përfundimtar Global tek NEMO. Më pas, NEMO i dërgon ato në Modulin e Verifikimit të OST-ve, kur është rasti.



1.1. Përmbledhje

Kjo procedurë fillon pasi Rezultatet Përfundimtare Globale të Rezultateve të Bashkimit të Tregut janë dërguar nga Sistemi TI i Ofruesit të Shërbimit MC, në Sistemin Lokal të Tregtimit të NEMO-s dhe janë konfirmuar nga OST-të. Këto Rezultate Përfundimtare Globale përmbajnë konfirmimin e rezultateve të Bashkimit të Tregut.

NEMO do të publikojë Rezultatet e Bashkimit të Tregut pas marrjes së Rezultateve Paraprake MC, në orarin që është rënë dakord në Procedurat që tregojnë se Rezultatet e Bashkimit të Tregut janë Paraprake.

Pas marrjes së Rezultateve Paraprake të Bashkimit të Tregut, në kohën e dakorduar në Procedurën e Tregtimit, se pari NEMO do të publikojë këto rezultate me një shënim se këto Rezultate janë Paraprake, dhe së dyti NEMO do të publikojë Rezultatet e Bashkimit të Tregut pas marrjes së Rezultateve Përfundimtare Globale.

Sistemi i TI i OST-ve kryen verifikimin e Rezultateve të Bashkimit të Tregut. Pasi Sistemet e Verifikimit të kenë verifikuar Rezultatet e Bashkimit të Tregut përkundrejt Kapaciteteve Ndërkufitare dhe Kufizimeve të mundshme të Alokimit, një Rezultat Përfundimtar i Bashkimit të Tregut i dërgohet Sistemit Lokal të Tregtimit të NEMO-s, i cili i përcjell automatikisht Rezultatet Përfundimtare të Bashkimit të Tregut më tej tek Sistemi TI i Ofruesit të Shërbimit MC.

Rezultatet Përfundimtare të Bashkimit të Tregut duhet të merren nga Sistemi TI i Ofruesit të Shërbimit MC jo më vonë se █████ minuta pas momentit të dërgimit të Konfirmimit Paraprak Global drejt Sistemit të Tregtimit Lokal të NEMO-s.

Pasi të jenë marrë Rezultatet Përfundimtare të Bashkimit të Tregut nga Sistemi TI i Ofruesit të Shërbimit MC, Sistemi Lokal i Tregtimit të NEMO-s merr Rezultatet Përfundimtare Globale nga

Ofruesi i Shërbimit MC dhe i përcjell ato më tej tek Sistemet e Verifikimit që kanë konfirmuar Rezultatet e Bashkimit të Tregut.

NEMO konfirmon se Rezultatet e Bashkimit të Tregut që u publikuan si paraprake tani mund të konsiderohen si përfundimtare, pas marrjes pozitive së Rezultateve Përfundimtare Globale.

1.2. Qeverisur / Rregulluar nga

- Marrëveshja Operacionale e Bashkimit të Tregut të Ditës në Avancë (DACOA)
- Proceduar NEMO- Ofruesi i Shërbimit MC

1.3. Mjetet dhe Protokollin e Komunikimit

- Sistemi Lokal i Tregimit të NEMO-s:
- Sistemin TI të OST-ve

1.4. Procedurat shoqëruese

Procedura vijuese:

- IDC_NOR_03: Llogaritja dhe Transferimi i Shkëmbimeve të Skeduluara

Procedura dhe rregulla të tjera të lidhura:

- IDC_BUP_02: Rezultatet Përfundimtar të Bashkimit të Tregut
- IDC_FAL_01: Menaxhimi i Incidenteve
- IDC_OTH_02: Komunikimi i brendshëm dhe i jashtëm
- Rregullat e Tregut të energjisë elektrike dhe Procedurat e Tregut të NEMO-s
- Rregullat e verifikimit të OST-ve (kontrollat për validimin e rezultateve të Bashkimit të Tregut, arsyet e refuzimit të tyre)

2. Procedura

2.1. Parakushtet për të filluar

Parakushti për të filluar këtë proces është realizimi me sukses i Konfirmimit Paraprak gjatë të cilit NEMO ka marrë Konfirmimin Paraprak Global nga Ofruesi i Shërbimit MC dhe publikimi si paraprak i Rezultateve të Bashkimit të Tregut për OST-të dhe Anëtarët e Bursës.

2.2. Pasqyrë e përgjithshme




Tabela e mëposhtme liston proceset e përgjithshme të IDC në lidhje me Rezultatet Përfundimtare MC të Rezultateve të Bashkimit të Tregut.

Shënim: Ju lutemi vini re se rreshtat me ngjyrën gri nuk përfshihen në procedurën 'IDC'. Këto janë hyrje ose dalje që ndihmojnë për ta kuptuar këtë procedurë.

Tabela 2 – Procesi i Rezultateve Përfundimtare të Bashkimit të Tregut IDC

#	Procesi	Segmenti i Tregut	Koha e Synuar	Koha e Përfundimit	Nga	Tek	Procedure Rezerve	Procedure Alternative
7a.	Dërgimi i Rezultateve të Bashkimit të Tregut si Rezultate Përfundimtare MC	CRIDA-1	■	-	Sistemi Lokal i Tregtimit të NEMO-s	Sistemet e verifikimit	IDC_BUP_02	-
		CRIDA-2	■	-				-
		CRIDA-3	■	-				-
8a.	Procesimi i Rezultateve Përfundimtare MC: verifikimi i Rezultateve të Bashkimit të Tregut kundrejt Kapaciteteve Ndërkufitare dhe Kufizimeve të mundshme të Alokimit	CRIDA-1	■	■	-	-	IDC_BUP_02	IDC_FAL_01
		CRIDA-2	■	■	-	-		
		CRIDA-3	■	■	-	-		
8b	Marrja e Rezultateve Përfundimtare të Bashkimit të Tregut	CRIDA-1	■	■	Sistemet e Verifikimit	Sistemi Lokal i Tregtimit të NEMO-s	IDC_BUP_02	-
		CRIDA-2	■	■				-
		CRIDA-3	■	■				-
8c	Dërgimi i Rezultateve Përfundimtare MC				Sistemi Lokal i Tregtimit të NEMO-s	Sistemi TI i Ofruesit të Shërbimit MC	-	-
8d	Procesimi i Rezultateve Përfundimtare MC i Ofruesit të Shërbimit MC				-	-	-	-
8e	Dërgimi i Rezultateve Përfundimtare Globale të NEMO-s				Sistemi TI i Ofruesit të Shërbimit MC	Sistemi Lokal i Tregtimit të NEMO-s	-	-
8f	Dërgimi i Rezultateve Përfundimtare Global	CRIDA-1	■	-	Sistemi Lokal i Tregtimit të NEMO-s	Sistemet e verifikimit	IDC_BUP_02	-
		CRIDA-2	■	-				-
		CRIDA-3	■	-				-

2.3. Sqarimi i Procesit

2.3.1. Dërgimi i Rezultateve të Bashkimit të Tregut për konfirmimin përfundimtar (7a)

Pasi Sistemi Lokal i Tregtimit të NEMO-s të ketë marrë Konfirmimin Paraprak Global nga Sistemi TI i Ofruesit të Shërbimit MC, Sistemi Lokal i Tregtimit të NEMO-s dërgon rezultatet e Bashkimit të Tregut tek Sistemin TI i OST-ve për të konfirmuar Rezultatet e Bashkimit të Tregut. Ky hap bëhet në të njëjtën kohë me publikimin si paraprake të Rezultateve të Bashkimit të Tregut për Anëtarët e Bursës.

Rastet e rrezikut	Masat e marra
1. Sistemi Lokal i Tregtimit të NEMO-s nuk mund t'i dërgojë Rezultatet e Bashkimit të Tregut tek OST-të.	IDC_BUP_02

2. Sistemi TI i OST-ve nuk mund të marri Rezultatet e Bashkimit të Tregut.	IDC_BUP_02
--	------------

2.3.2. Verifikimi i Rezultateve të Bashkimit të Tregut (8a)

Sistemet TI të OST-ve kryejnë kontrollin kundrejt Kapaciteteve Ndërkufitare dhe Kufizimeve të Alokimit.

Arsyeja e refuzimit është se pozicionet neto nuk korrespondojnë me Kapacitetet Ndërkufitare.

Rezultati i procesit të verifikimit është Rezultatet Përfundimtare MC i Rezultateve të Bashkimit të Tregut. Ky konfirmim mund të jetë pozitiv ose negativ. Në rastin e këtij të fundit, Sistemet e Verifikimit duhet të deklarojnë qartë në skedarin e konfirmimit arsyen e refuzimit. Sapo të jetë dërguar konfirmimi përfundimtar negativ, OST-të duhet të telefonojnë NEMO-n për t'i informuar për arsyen e refuzimit.

Rastet e rrezikut	Masat e marra
3. Sistemet TI të OST-ve nuk arrijnë të kryejnë verifikimin e Rezultateve të Bashkimit të Tregut (problem teknik).	IDC_BUP_02

2.3.3. Marrja e Rezultateve Përfundimtare MC nga Rezultatet e Bashkimit të Tregut (8b)

Pasi Sistemi TI i OST-ve të ketë verifikuar Rezultatet e Bashkimit të Tregut, Rezultatet Përfundimtare MC i dërgohen Sistemit Lokal të Tregtimit të NEMO-s, i cili do ta përcjellë me tej tek Sistemi TI i Ofruesit të Shërbimit MC.

Në rast të një Rezultati negativ Përfundimtar MC, pala që e ka kete të drejtë për te konfirmuar Rezultatet e Bashkimit të Tregut, duhet të kontaktojë NEMO-n sa më shpejt që të jetë e mundur.

Nëse NEMO as nuk ka marrë një konfirmim pozitiv dhe as nuk është informuar për një problem lidhur me konfirmimin brenda ■ minutave pasi Rezultatet e Bashkimit të Tregut të jenë dërguar në Sistemet e Verifikimit, NEMO do të kontaktojë entitetin validues përkatës që e validon rezultatin për të kryer një verifikim rreth konfirmimit të statusit.

Rastet e rrezikut	Masat e marra
4. Sistemi TI i OST-ve mund të verifikojë Rezultatet e Bashkimit të Tregut, por nuk arrin të gjenerojë Rezultatit Përfundimtar MC.	IDC_BUP_02
5. Sistemi TI i OST-ve nuk mundet ta dërgojnë Rezultatit Përfundimtar MC në kohën e përcaktuar, pa cenuar kohën e caktuar për t'i dhënë Rezultatit Përfundimtar MC Sistemit TI të Ofruesit të Shërbimit MC.	IDC_BUP_02
6. Sistemi Lokal i Tregtimit i NEMO-s nuk mund ta marrë Rezultatit Përfundimtar MC.	IDC_BUP_02
7. Sistemi Lokal i Tregtimit i NEMO-s merr një konfirmim negativ nga Sistemet TI të OST-ve.	IDC_FAL_01

2.3.4. Dërgimi si Rezultate Përfundimtare Globale të Rezultateve të Bashkimit të Tregut (8f)

Pasi Sistemi Lokal i Tregtimit të NEMO-s të ketë marrë Rezultatit Përfundimtar Global nga Ofruesi i Shërbimit MC, Sistemi Lokal i Tregtimit NEMO ia përcjell atë Sistemin TI të OST-ve.

Një Rezultat pozitiv Përfundimtar Global do të thotë që Rezultatet e Bashkimit të Tregut janë tashme përfundimtare.

Një Rezultat negativ Përfundimtar Global do të thotë që, të paktën një palë që ka të drejtë të konfirmojë Rezultatet e Bashkimit të Tregut, i ka refuzuar ato dhe si pasojë do të iniciohet një Komitet i Incidencës në përputhje me IDC_FAL_01.

Rastet e rrezikut	Masat e marra
8. Rezultati pozitiv Përfundimtar Global nuk mund të gjenerohet nga Ofruesi i Shërbimit MC.	IDC_BUP_02

9. Konfirmimi pozitiv Paraprak Global merret shumë vonë për të mundësuar kompletimin e procesimit të Rezultateve Përfundimtare MC duke çuar në një pranim te supozuar (kohë e pamjaftueshme për të bërë validimin).	IDC_BUP_02
10. Sistemi Lokal i Tregtimit të NEMO-s nuk mund ta dërgojë Rezultatin Përfundimtar Global tek Sistemet TI të OST-ve.	IDC_BUP_02
11. Sistemi TI i OST-ve nuk mund të marre Rezultatin Përfundimtar Global.	IDC_BUP_02
12. Sistemi TI i OST-ve merr Rezultatin Negativ Përfundimtar Global.	IDC_BUP_02
13. Rezultati Negativ Përfundimtar Global duhet të ndryshohet në një Rezultat pozitiv Përfundimtar Global.	IDC_BUP_02

2.4. Përfundimi

Procesi i Rezultatit Përfundimtar MC i Rezultateve të Bashkimit të Tregut konsiderohet i përfunduar kur Rezultati Përfundimtar Global i Rezultateve të Bashkimit të Tregut është marrë me sukses nga sistemet përkatëse të të gjitha palëve që kanë konfirmuar Rezultatet e Bashkimit të Tregut.